



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Bujqësi dhe
Zhvillim Rural



Datë:	10.08.2026
Për:	MBPZHR – Departamenti i Prodhimtarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
Nga:	Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Donika Prenku
Lënda:	Raport rreth korrje-shirjeve në territorin e komunës së Drenasit 2026

Raport

Me Aktvendimin e Drejtorisë për Bujqësi, dhe Zhvillim Rural, me nr. protokolli 01 Nr. [020/04-25811](#), datë 02.07.2026, është përcaktuar çmimi orientues për shërbimet e korrje-shirjeve në vlerë prej **140.00 € për hektar**, çmim i dakorduar ndërmjet fermerëve dhe operatorëve të autokombajnave.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në territorin e Komunës së Drenasit gjatë vitit 2026 me drithëra të bardha janë mbjellë gjithësej **3,235.00 hektarë**.

Para fillimit të fushatës së korrje-shirjeve, Drejtoria ka ndërmarrë të gjitha përgatitjet e nevojshme organizative dhe teknike. Janë inspektuar dhe verifikuar autokombajnave që kanë marrë pjesë në fushatë, ndërsa numri i tyre ka qenë rreth **40 autokombajna**.

Fushata e korrje-shirjeve ka filluar më **04.07.2026** dhe ka përfunduar më **06.08.2026**, me kohëzgjatje prej **29 ditësh**.

Bazuar në të dhënat e grumbulluara në terren, rendimenti mesatar i grurit ka qenë **5,100 kg/ha**, duke shënuar rezultate më të mira krahasuar me vitet paraprake. Kushtet klimatike gjatë sezonit kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e kulturave bujqësore dhe në rritjen e rendimentit.

Rendimenti mesatar sipas kulturave paraqitet në tabelën vijuese.

Kultura	Sipërfaqet e mbjellura	Rendimenti mesatar kg
Grurë	2970	5100
Elb	40	4300
Thekër	25	4400
Tërshër	90	3500

Gjatë realizimit të fushatës së korrje-shirjeve janë evidentuar disa sfida, kryesisht të lidhura me përdorimin e autokombajnave me vjetërsi të madhe. Në disa raste janë vërejtur humbje të sasisë së grurit si rezultat i konsumimit të hederit dhe mekanizmit të shirjes.

Gjithashtu, numri i vogël i pikave grumbulluese në territorin e Komunës së Drenasit ka bërë që një pjesë e fermerëve të dorëzojnë prodhimin jashtë komunës, duke rritur kostot e transportit dhe kohën e dorëzimit.

Gjatë gjithë periudhës së korrje-shirjeve, Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në bashkëpunim me komisionin komunal dhe administratorët e fshatrave, ka zhvilluar aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere për ndalimin e djegies së hamulloreve.

Falë këtyre aktiviteteve dhe bashkëpunimit me qytetarët, gjatë këtij sezoni nuk janë evidentuar raste të djegieve masive të hamulloreve në territorin e Komunës së Drenasit.

Rekomandim:


Për përmirësimin e mëtejshëm të organizimit dhe efikasitetit të fushatës së korrje-shirjeve rekomandohen:

- Të mbështetet modernizimi i mekanizmit bujqësor përmes programeve të investimeve dhe subvencionimit të autokombajnave të reja.
- Të organizohen trajnime periodike për operatorët e autokombajnave lidhur me standardet teknike, zvogëlimin e humbjeve gjatë korrjes dhe rritjen e efikasitetit të punës.
- Të rritet numri i pikave grumbulluese dhe kapacitetet për pranimin e grurit në territorin e Komunës së Drenasit.
- Të vazhdojnë aktivitetet vetëdijësuese për ndalimin e djegies së hamulloreve dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Të vazhdojë bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet Komunës, Ministrisë së Bujqësisë dhe shoqatave të fermerëve për përmirësimin e organizimit të fushatës së korrje-shirjeve.

Përfundim: Bazuar në të dhënat e mbledhura nga komisioni komunal për korrje-shirje, vlerësohet se fushata e korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Drenasit është realizuar me sukses, brenda afateve të planifikuara dhe pa probleme madhore organizative. Rendimentet e arritura paraqesin një rezultat të kënaqshëm dhe më të lartë krahasuar me vitet paraprake, duke reflektuar angazhimin e fermerëve, operatorëve të autokombajnave dhe institucioneve përgjegjëse.

Anëtarët e komisionit komunal për korrje- shirje

1. Donika Prenku – Kryetar – (Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural)
2. Ilir Berisha – Anëtar (Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural)
3. Mensur Gllareva – Anëtar (Drejtorati i Inspeksionit)
4. Sejdi Kozhani (Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjente)
5. Anita Avdullahu- Dvorani (Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural)



lu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- DBZHR-së
- Anëtareve të komisionit.

DRENAS-GUSHT, 2026
